



BASHKIA MIRDITË

Nr 3671/prot.
1

Rrëshen më 11/10 / 2024

MIRATOHET
KRYETARI
Albert MËLYSHI



**PLANI STRATEGJIK DHE VJETOR I SEKTORIT TË AUDITIMIT TË
BRENDSHËM NË BASHKINË MIRDITË PËR PERIUdhËN 2025 – 2027.**

Sektori i auditimit të brendshëm në Bashkinë Mirdite (NJAB) është ngritur në zbatim të ligjit për auditimin e Brendshëm në sektorin publik 114/2015 dhe të VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “ Për Miratimin e Kritereve të krijimit të Njësive të auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, në mesin e vitit 2017 dhe vazhdon konsolidimin e saj në harmoni me Drejtoritë dhe sektorët e tjerë të aparatit të bashkisë në varësi direkte të Kryetarit të Bashkisë. Në zbatim të standarteve të auditimit stafi i kësaj njësie po punon për ngritjen e nivelit profesional të strukturës. Aktualisht NJ.A.B. Bashkia Mirditë funksionon në nivel Sektorit.

Në hartimin e planit strategjik dhe vjetor 2025-2027 jemi fokusuar në planifikimin me bazë risku dhe kemi synuar që të shmangim mbivendosjet për subjektet, të cilat janë audituar nga institucione të tjera. Jemi përpjekur të identifikojmë risqet për çdo fushë në përputhje me standartet ndërkombëtare të auditimit, legjislacionin dhe Kartën e Auditimit të pranuar dhe shpallura nga Ministri i Financave.

A.PLANI STRATEGJIK

1.STRUKTURA E PLANIT STRATEGJIK

- 1.1 Qëllimi i planit strategjik dhe misioni i NJAB
- 1.2 Organizimi i NJAB dhe kuadri ligjor
- 1.3 Objektivat strategjik
- 1.4 Identifikimi i subjekteve
- 1.5 Identifikimi i fushave /sistemeve prioritare
- 1.6 Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve
- 1.7 Kufizimet e Auditimit
- 1.8 Prioritetet për tre vite

1.1 Qëllimi i Planit Strategjik dhe Misioni i NJAB

Qëllimi i Planit Strategjik është të përcaktoje drejtimet në të cilat do të zhvillohet veprimtaria e strukturës së auditimit të brendshëm në sektorin publik gjatë periudhës për të cilën po hartohet ky plan, kohën dhe burimet e nevojshme për realizimin e objektivave duke u bazuar në analizën e riskut për fushat të cilat mbulon ky funksion. Të shtojë vlerën nëpërmjet përmirësimit të operacioneve të institucionit në sektorin publik duke siguruar përdorimin me dobi, kursim dhe frytshmeri të fondeve publike .

Plani Strategjik është dokument i cili përcakton strategjinë për veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Mirditë. Kjo strategji u përgatit për periudhën 2025-2027 nga Sektori i Auditimit të Brendshëm miratuar nga Kryetari i bashkisë.

Plani strategjik 2025-2027 “Për veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në Njësinë Publike, ka si qëllim identifikimin e sistemeve, fushave me nivel të lartë risku, ku nëpërmjet analizës së tij përcakton mbulimin dhe frekuencën e auditimit.

Plani strategjik përcakton punën që do të ndërmerret nga Sektori i Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Mirditë për periudhën e ardhshme 2025-2027.

Funksioni i Auditimit të Brendshëm është pjesë e veprimtarisë aktuale të Bashkisë Mirditë duke u konsultuar e rënë dakort me menaxhimin e lartë lidhur me problemet e kontrolleve të brendshme

dhe të administrimit, i cili synon të zbatojë në mënyrë efektive mbulimin e sistemeve, e fushave kryesore me risk më të lartë.

Hartimi dhe miratimi i planit strategjik është kërkesë e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe përgjegjësi e drejtuesit të Sektorit të Auditit të Brendshëm për hartimin dhe dërgimin për miratim tek Titullari i Njesisë Publike dhe dërgimin për informim në Strukturën Përgjegjëse për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm, në Ministrinë e Financës.

Sektori e Auditit të Brendshëm, duke u konsultuar e rënë dakort me menaxhimin lidhur me problemet e kontroleve të brendshme dhe administrimit, synon të zbatojë në mënyrë efektive mbulimin me auditim të veprimtarive kryesore dhe me risk të lartë të përcaktuar në këtë plan.

Angazhimet e auditimit të brendshëm në Planin Strategjik 2025-2027 janë vlerësuar mbi bazën e nevojave tre vjeçare për auditime, mbi bazën e një rishikimi të përgjithshëm të subjekteve që i nënshtrohen auditimit, identifikimit të sistemeve dhe fushave të veprimtarive mbi bazë risku, si dhe burimet njërëzore të planifikuara në dispozicion të Sektorit të Auditit të Brendshëm.

Vizioni: Të shtojë vlerë nëpërmjet përmirësimit të performancës në subjektet e audituara në njësinë publike duke siguruar përdorimin me dobi, kursim, dhe frytshmëri të fondeve publike.

MISIONI: Misioni i Sektorit të Auditit të Brendshëm në Njësine Publike është që të ndihmojë Titullarin për të arritur objektivat e vendosura për Njësine publike, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike duke vlerësuar dhe rekomanduar përmirësimin menaxhimit të riskut dhe proceset e kontrollit të brendshëm, në drejtim të zbatimit të ligjit, rregullave dhe kontroleve të vendosura, vlerësimit të dobisë, frytshmërisë dhe efektivitetit të veprimeve. Dhënien në mënyrë të pavarur të një sigurie të arsyeshme për Kryetarin e bashkisë me qëllim:

- Përmirësimin e veprimtarisë së Njesisë Publike dhe subjekteve vartëse të saj.
- Rritjen e frytshmërisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm.
- Shqyrtimin, vlerësimin dhe dhënien e rekomandimeve për sistemet e kontrollit të brendshëm për përmirësimin e tyre, për të arritur objektivat e caktuara duke përdorur burimet në mënyrë ekonomike dhe efçente.

Roli i auditimit të brendshëm është t’i japë mbështetje titullarit të Bashkisë Mirditë në arritjen e objektivave të institucionit :



a) duke përgatitur planet strategjike dhe vjetore për auditimin e brendshëm, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planin e miratuar si dhe ndryshimit të planit gjatë veprimtarisë vjetore audituese, nëse do këtë ndryshime.

b) duke vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve e të kontrolleve, duke u fokusuar kryesisht në:

i) identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike;

ii) përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë publike me kuadrin rregullator;

iii) ruajtjen e aseteve;

iv) besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional;

v) kryerjen e veprimtarisë së njësisë publike me ekonomi, efektivitet dhe efizienz;

vi) përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve;

c) duke dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit

të kontrollit të brendshëm të njësisë publike;

ç) duke ndjekur zbatimin e rekomandimeve të dhëna

1.2 Organizimi i NjAB dhe Kuadri Ligjor

Organizimi i NjAB: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Mirditë është e organizuar në nivel sektori me varësi direkte nga Kryetari i Bashkisë. Veprimtaria e sektorit të auditimit të brendshëm është pjesë e strukturës së Bashkisë Mirditë. Struktura e Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Bashki është e përbërë nga 1 përgjegjës dhe 2 specialistë, ku përgjegjësi dhe të 2 specialistët janë të certifikuar. Ju vëmë në dijeni se përgjegjësja e sektorit është emëruar në muajin shkurt 2024 dhe është e certifikuar si audituese e brendshme në sektorin publik.

Kuadri Ligjor: Funkionimi i auditimit të brendshëm në Bashkinë Mirditë, bazohet në Ligjin Nr.114 datë 22.10.2015 “ Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, në akte të tjera ligjore e nën ligjore të cilat rregullojnë këtë veprimtari, Manuali i Auditimit të Brendshëm,

praktikat profesionale ndërkombëtare që përmbajnë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm.

Kuadri ligjor në Njësinë Publike :

1. Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
2. Ligji nr. 115/2014, datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”
3. Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
4. Ligji nr. 152/2013 datë 13.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
5. Ligji nr. 10294, datë 1.07.2010 “Për Inspektimin Financiar Publik.
6. VKM nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

Kuadri ligjor për Auditimin e Brendshëm në Njësinë Publike.

1. Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
2. Urdhri i Ministrit të Financave nr. 69, datë 29.09.2010 “Për miratimin e Manuali i Auditimit të Brendshëm”;
3. VKM nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”;
4. VKM nr. 160, datë 2.3.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike”;
5. Urdhri i Ministrit të Financave nr. 86, datë 10.12.2015 “Për miratimin e Kodit të Etikës për Audituesit e Brendshëm në Sektorin Publik”
6. Manuali i Auditimit të Brendshëm si dhe akte të tjera ligjore e nën ligjore.

1.3 Objektivat Strategjik

- Të përdorë një metodologji Auditimi bashkëkohore që përputhet me standardet e pranuar ndërkombëtare të Auditimit dhe të Njesisë Qëndrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.
- Sigurimin për Titullarin e Njesisë Publike të një sistemi vlerësimi eficient të burimeve dhe aseteve në njësine publike për:

-Vlerësimin e sistemit financiar për planifikimin dhe hartimin e buxhetit,



-Vlerësimin që kontrollet e brendshme janë të përshtatshme të parandalojnë gabimet, abuzimet, shpenzimet e tepërta.

- Rritjen e vazhdueshme të kualifikimit të audituesve përmes trajnimeve në fushën e procedurave dhe metodave/teknikave të auditimit si dhe teknikave mbi vlerësimin e riskut.
- Rritja e cilësisë dhe e performancës së auditimeve me shtimin e numrit dhe cilësisë së zbulimeve si impakt në rritje, kjo i shërben përmirësimit të menaxhimit dhe shtimit t

vlerës

- Të raportoje në mënyrë periodike tek Titullari i Njesisë publike për misionet e realizuara, problemet e evidentuara dhe rekomandimet në përmbushje të tyre si dhe në DHAB në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

1.4 Identifikimi i Subjekteve

Identifikimi i subjekteve për tu audituar është bërë në bazë strukturës së re të Bashkisë Mirditë për vitin 2024, kjo strukturë është miratuar me urdhër nr.2 dt. 8.01.2024, nr.90 prot. më dt.8.1.2024.

Për periudhën 3-vjeçare (2025-2027), auditimi në Bashkinë Mirditë dhe njësitë vartëse, do të fokusohet në mbulimin me auditim të gjithë subjekteve të varësisë, gjë e cila do të realizohet në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016.

Në planin strategjik (2025 – 2027), janë planifikuar për tu audituar subjektet sipas viteve:

-Viti 2025, janë planifikuar për tu audituar 5 (pesë) subjekte:

I (katër) nga të cilët janë vlerësuar me risk të lartë përkatësisht :

1. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave -

- **1.1** Sektori i buxhetit dhe finances
- **1.2** Sektori i Tatim Taksave dhe nxitja e biznesit

dhe 2 (dy) me risk te mesëm

2. Drejtoria Juridike, Prokurimeve Publike dhe Protokollit

- 2.1 Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Përshkrimit Punës dhe A.Përgjegjës
- 2.2 Sektori i Marrdhënieve me qytetarët eventeve dhe IT
- 2.3 Njësia për koordinimin e integritimit europian dhe projekteve
- 2.4 Sektori juridik dhe prokurimeve
- 2.5 Sektori i Arkivit dhe Protokollit

3. Policia bashkiake

Dhe dy me risk të ulët ;

4. Njësia Administrative Kaçinar
5. Njësia Administrative Rubik

-Viti 2026, janë planifikuar për tu audituar 8 (tetë) subjekte, nga të cilat:

Me risk të mesëm janë vlerësuar 6 (gjashte) subjekte :

1. Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit Territorit
2. Agjencia e Arsimit Sportit dhe Ndihmës Sociale
3. Agjencia e Bujqësisë Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve
4. Agjencia e Inspektimit Kontrollit dhe Emergjencave
5. Njësia Administrative Fan
6. Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore dhe Turizmit

Dhe 2(dy) me risk të ulët;

1. Njësia Administrative Orosh
2. Njësia Administrative Kthellë

-Viti 2027 , janë planifikuar për tu audituar 7 (shtatë) subjekte nga të cilat 6 (gjashtë) janë me risk të mesëm

1. Agjencia e Inspektimit, Kontrollit dhe Emergjencave.
 - 1.1 Emergjencia Civile
 - 1.2 MZSH

2. Agjencia e Bujqësisë Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve

- 2.1 Sektori i bujqësisë dhe kadastrës
- 2.2 Inspektoriati i Mjedisit dhe Pyjeve
- 2.3 Sektori i Sh. Veterinar, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

3. Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit

dhe 1 (një) me risk të ulët;

4. Njësia Administrative Selitë

Frekuenca e auditimit

Frekuenca e auditimit për subjektet e Bashkisë Mirditë, bazuar në këtë planifikim, nuk do të jetë më shumë se 3 vite, me planifikimin e auditimit për **Detyrimet e Prapambetura si dhe Zbatimin e Rekomandimeve**. Realizimi i programit 3-vjeçar (2025-2027) dhe vjetor 2024, është i lidhur me disa faktorë të jashtëm dhe të brendshëm :

Faktorët e jashtëm :

1. Ndryshimet në legjislacion.
2. Struktura të pamjaftueshme për të përmbushur kërkesat ligjore.

Faktorët e brendshëm :

- Organizimi dhe funksionimi i njësisë së auditimit.
- Ndryshimi i numrit të subjekteve për auditim.
- Viti elektoral

Duke ju referuar këtyre faktorëve, plani i auditimit për 3 vitet e ardhshme është hartuar me qëllim mbulimin me auditim të të gjithë subjekteve të varësisë. Konkretisht janë planifikuar që për periudhën trevjeçare të mbulohen me auditim 100% e subjekteve të planifikuara për auditim.

1.5 Identifikimi i fushave/sistemeve prioritare

Auditi i Brendshëm duke ju referuar misionit që ka dhe qëllimit të tij, identifikimin dhe vlerësimin e riskut për përmirsimin e sistemeve të menaxhimit të riskut, gjatë përgatitjes së planit strategjik 3-vjeçar vëmëndja është fokusuar tek **sistemet financiare dhe në sistemet e përputhshmerise**. Duke ju referuar këtyre sistemeve kemi bërë planifikimin e angazhimeve të auditimit me baze rrisku për të gjitha fushat.

1.6 Identifikimi dhe vleresimi i risqeve

Një ndër hapat e parë gjatë hartimit të planit të auditimit të brendshëm është njohja me organizatën, mjedisin ku ajo vepron dhe risqet kryesore me qëllim që plani strategjik të fokusohet në sistemet/fushat që paraqesin risk më të lartë.

Fushat me risk më të lartë të identifikuara në Bashkinë Mirditë gjatë kryerjes së misioneve të auditimit janë:

- Sistemi i zbatimit të buxhetit sipas zërave të miratuar si dhe ndjekja në vazhdimësi e zbatimit të tij -Detyrimet e prapambetura.
- Sistemi I kontrollit të regjistrimit mbi detyrimet e paguara për taksat dhe tarifatat vendore gjatë vitit nga subjektet private dhe institucionet shtetërore

Risqet e identifikuara sipas sistemeve

Risqet e identifikuara sipas sistemeve janë vlerësuar si më poshtë:

- Cilësia e sistemeve të kontrollit të brendshëm
- Pajtueshmëria me bazën ligjore dhe rregullative
- Madhësia e subjektit të audituar
- Kompleksitetin e transaksioneve

Përparësitë ku fokusohet auditimi mbështeten në rezultatet e vlerësimit të riskut duke filluar nga risku më i lartë deri tek risku më i ulët. Mbi bazën e këtij vlerësimi të riskut përparësitë në auditim do të jenë :

1. Rregullshmëria e planifikimit dhe përdorimit të burimeve financiare.
2. Zbatimi i procedurave të prokurimeve dhe investimeve.

3. Mirë administrimi i vlerave materiale dhe respektimi i normave të përdorimit të tyre.
4. Përmirësimi i rregullave dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm me qëllim menaxhimin sa më të mirë të aseteve dhe burimeve për arritjen e objektivave nga subjekti i audituar.

1.7 Kufizimet e Auditimit

Qëllimi dhe objektivat e auditimit mund të mos arrihen si rezultat i ndikimit të disa faktorëve si :

1. Ndryshimet strukturore të Njesisë së Auditimit të Brendshëm
2. Lëvizja e punonjësve të Auditimit të Brendshëm
3. Mbështetja materiale dhe motivimi në punë i punonjësve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm.
4. Mungesa e pavarësisë funksionale së audituesve.
5. Çertifikimi i audituesve .

1.8 Prioritet per vitet (1+2)

- Përmirësimi i frekuencës së auditimeve duke mbuluar me auditim të gjithë strukturën organizative dhe institucionet vartëse të bashkisë Mirditë.
- Përmirësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm mbi bazën e gjetjeve dhe rekomandimeve për rregullimet përkatëse administrative dhe ligjore.
- Rritja e kompetencës së stafit me programe të diferencuara trajnimi në lidhje me metodat dhe praktikat e reja të auditimit të brendshëm në sektorin publik.
- Ndjekja e realizimit të rekomandimeve.

B.PLANI VJETOR

Plani vjetor është një dokument që identifikon veprimtarinë e auditit të brendshëm që parashikohet të kryhet nga NJAB në subjektet publike gjatë kësaj periudhe . Ky plan është një dokument fleksibël në të cilin prioritetet aktuale në një ambient që ndryshon sipas kerkesave të standarteve profesionale do të jetë pjesë e dosjes së planit vjetor të çdo NJAB. Plani është hartuar duke synuar



pajtueshmërinë me detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në kuadrin ligjor dhe Kartën e Auditit të Brendshëm . Plani do të jetë një mjet për të monitoruar dhe harmonizuar veprimtarinë e strukturave audituese si dhe për të vlerësuar dhe pasqyruar ndryshimet e mundshme të risqeve me të cilat përballen subjektet publike për arritjen e objektivave .

2. STRUKTURA E PLANIT VJETOR

2.1 Zhvillimet aktuale të NJAB

2.2 Prioritetet e auditimit për vitin 2025

2.3 Objektivi (at) kryesore për vitin 2025

2.4 Programimi i llojit të angazhimeve

2.5 Planifikimi i kostos për vitin 2025

2.6 Planifikimi i burimeve për vitin 2025

2.7 Planifikimi i nevojave të stafit për trajnim

2.8 Sigurimi i brendshëm i cilësisë

2.1 Zhvillimet aktuale të NJAB

Referuar planifikimit të auditimeve për vitin 2024 Ju informojmë mbi realizimin e angazhimit të auditimeve deri në periudhën aktuale të raportimit.

Subjekte të planifikuara për auditim për vitin 2024(gjithsej 6 subjekte).

Nuk kemi pasur ndryshim plani për vitin 2024

Nga këto:

- Ka përfunduar procesi i auditimit në 3 subjekte.
- Janë në proces auditimi 1 subjekte.
- Ska filluar procesi në 2 subjekte.

2.2 Prioritetet e auditimit për vitin 2025

Në Planin Strategjik të konsoliduar për “Veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” janë përcaktuar prioritetet për periudhën 2025-2027. Duke qënë se plani vjetor është dhe pjesë e planit strategjik, përveç prioriteteve të sipërpërmendura, për vitin 2025 prioritet kryesor do të jenë:

- Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësitë publike.
- Kryerja e auditimeve në sistemet kryesore dhe me risk të lartë në subjektet publike, rritja e cilësisë së punës audituese për dhënien e rezultateve që shtojnë vlerë.
- Përditësimi dhe zbatimi e kuadrit ligjor, procedural e rregullator.
- Ngritja e zhvillimi profesional i burimeve njerëzore, për aftësimin e tyre në ushtrimin e funksioneve, detyrave dhe përgjegjësive të ngarkuara.
- Vlersimi se si janë përdor fondet e bashkisë.

2.3 Objektivi (at) kryesorë për vitin 2025

Objektivat kryesorë të cilat synon të arrijë auditimi i brendshëm gjatë vitit në vijim janë:

- Mbulimi me auditim i sistemeve/fushave ashtu siç është parashikuar në planin e vitit 2025 në këtë mënyrë AB i shton vlerë subjektit që auditon.
- Realizimi i veprimtarisë së AB me përkushtim dhe përgjegjësi, për ti shtuar vlerë institucionit të Bashkisë Mirditë bazuar në risk mbështetur në kuadrin ligjor dhe rregullator, performancat e mëparshme dhe sistemet e kontrollit të brendshëm.
- Kryerja e misionëve të AB në përputhje me Ligjin e ndryshuar të AB, Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe Standartet Ndërkombëtare .
- Realizimi i trajnimeve dhe ngritja e nivelit profesional të AB në sektorin publik.

2.4 Programimi i llojit të angazhimeve.

Në përgatitjen e Planit Strategjik të AB-së, janë marrë parasysh pritshmëritë e palëve të interesuara. Komunikimi me Titullarin e Njesise Publike, drejtorët e drejtorive përkatëse përgjegjësit e sektorëve dhe administratorët e njesive administrative. Ky komunikim është i dobishëm për të shtuar efektivitetin e planifikimit të auditimit dhe për të hartuar një plan të aktiviteteve të auditimit, i cili do të përmbushë apo mund të adresojë më mirë nevojat e palëve të interesuara dhe t'u japë përparësi pritshmërive të tyre.



Për hartimin e planit të veprimtarisë audituese për vitin 2025 u bazuam në strukturën e miratuar të njesise dhe në kohën e punës që zë çdo proces pune audituese sipas stadeve të auditimit, që mund të kryej një auditues/grup auditimi gjatë një viti si dhe në numrin aktual të stafit të AB.

Për vitin 2025 u planifikuan 5 auditime gjithsej.

1.Auditim përputhshmërie 4

1.Auditim financiar 1

Për auditimet e llojit “shërbim konsulence” nuk e kemi parashikuar, pasi nuk kemi pasur kërkesa nga Titullari i Bashkise apo Titullarët e institucioneve vartëse gjatë hartimit të këtij plani, për kryerjen e këtij lloji shërbimi auditimi.

2.5 Planifikimi i kostos për vitin 2025

Një nga fazat e përgatitjes së planit vjetor është planifikimi i kostos sipas nevojave që paraqiten nga veprimtaria e Njesisë së Auditimit të Brendshëm. Me konsolidimin e të dhënave, rezulton se kosto për vitin 2025 është në vlerën e 4 814 660 (kater million teteqind e katermbedhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtë dhjetë) lekë, ku paga dhe sigurime shoqërore janë në vlerën 4 694 660 lekë, shpenzime udhëtime dhe dieta janë 75 000 lekë , të tjera 45 000 lekë dhe kosto mesatare për person është 1 604 887 lekë. Sektori i Auditimit përbehet nga 1 përgjegjës dhe 2 specialiste.

2.6 Planifikimi i burimeve për vitin 2025

Sipas nevojave që paraqiten nga veprimtaria e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, në fazën e përgatitjes së planit vjetor është planifikimi I burimeve. Ky proces është i rëndësishëm për të siguruar mbulimin me burime të përshtatshme të nevojave të auditimit në përgjithësi dhe sidomos të sistemeve me risk të lartë. Kjo për faktin se në një veprimtari auditimi, pjesa më e madhe e burimeve duhet të përqëndrohet në auditimin e sistemeve të vlerësuara me risk të lartë. Në burimet e planifikuara për vitin 2024 koha maksimale e vlefshme është 780 ditë. Pushime vjetore- 60 ditë, ditë pushimi (festa zyrtare)-39 ditë, pushime për arsye shëndetsore-15 dite, angazhime në trajnime-15 ditë, angazhime në mbledhje/takime -12 ditë,rezerva të planifikuara(të papritura)-15 ditë. Gjatë vitit 2025 Njësia e Auditimit të

Brendshëm ka planifikuar të ketë në dispozicion 624 ditë pune, ku secili punonjës ka në dispozicion 208 ditë pune.

2.7 Planifikimi i nevojave të stafit për trajnim

Një nga elementët që kemi mbajtur parasysh në planifikimin e nevojave për kualifikime është e percaktuar si kërkesë e ligjit “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” ku auditet në detyrë kanë të domosdoshme pjesëmarrjen në trajnimet përditësuese në nivelin e 40 orëve në vit. Kemi percaktuar sipas gjykimit tonë edhe disa nga drejtimet kryesore ku kemi nevojë të fokusohemi në keto trajnime, me qëllim përditësimin e njohurive dhe shkëmbimin e eksperiencës me kolegët e rretheve të tjera dhe me trajnerët.

Struktura e auditimit të brendshëm përbëhet nga 1 përgjegjës auditimi dhe 2 specialist auditimi.

Temat e identifikuara për trajnim për vitin 2025 janë:

- Harta dhe manuali I proceseve të punës dhe gjurma e auditimit.
- Sistemi I kontrollit të brendshëm financiar public në njësinë e qeverisjes vendore.
- Trajnimi I vijueshëm profesional

Reformat e ndërmarra në fushën e menaxhimit të financave publike janë fokusuar në drejtim të rritjes së përgjegjësisë së menaxhimit për përdorimin me efektivitet, efizienz dhe ekonomi të fondeve publike dhe krijimin e përsosjen e një sistemi të qëndrueshëm dhe modern të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Shqipëri. Ndryshimet në Ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Ligjin për Inspektimin Financiar dhe Ligjin për Financat Vendore. Në zbatim të kuadrit ligjor në fushën e financave publike, synojmë një strukturim të sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar dhe Auditimit të brendshëm në përputhje të plotë me standartet ndërkombëtare të pranuar. Veprimtaria e Auditimit të Brendshëm kryhet në mënyrë të vazhdueshme me qëllim që të vlerësojë dhe përmirësojë strukturat e menaxhimit efektiv të riskut dhe të kontrollit të transaksioneve financiare dhe në këtë kuadër bëhet hartimi i një Plani 3-vjeçar dhe detajimi i Planit Vjetor të Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm.

Plani strategjik si dhe plani vjetor bazohen mbi një rishikim të përgjithshëm të sistemit të auditimit si dhe të sistemeve e proceseve që në kuadrin e reformës administrative-teritoriale janë ndërmarrë. Vlerësimi i nevojave të auditimit rishikohet çdo vit në kohën kur hartohet plani vjetor i auditimit për vitin e ardhshëm, duke u siguruar, që janë të përfshira në planin e konsoliduar të gjitha veprimtaritë e reja dhe/ose ndryshimet e tjera të programeve.



Veprimtaria e auditimit të brendshëm me misionet e auditimit që kryen (subjektit të audituar) duhet të japë siguri titullarit se fondet publike janë përdorur me ekonomi, efikasitet dhe eficensë dhe sipas planit dhe qëllimit të miratuar me ligjin e buxhetit.

2.8 Sigurimi i brendshëm i cilësisë

Rishikimi i punës audituese, ndikon drejtëpërsëdrejti në zbatimin e akteve ligjore, dhe nënligjore , standardeve kombëtare e ndërkombëtare të auditimit lidhur me këtë veprimtari. Rishikimi i cilësisë i kërkon çdo anëtar të grupit të auditimit që të kuptojë plotësisht si përgjegjësitë e tij, ashtu edhe rolin e anëtarëve të tjerë të grupit të auditimit. Të gjithë anëtarët e Njësisë së Auditimit janë përgjegjës për paraqitjen e rezultateve të punës së tyre sipas Standardeve, me qëllim që ti mundësojnë një anëtar tjetër të hierarkisë së rishikimit që ta përfundojë punën e tij në mënyrë efëcente dhe të efektshme. Për këtë arsye rishikimi i punës audituese duhet të ushtrohet në të gjitha proceset dhe veprimtaritë që lidhen me shërbimin e auditimit.

Rishikimi i punës audituese është përgjegjësi e drejtuesit, dhe kryhet në varësi të niveleve të funksioneve organizative të strukturave të auditimit. Në kushtet konkrete të vendit tonë rishikimi i punës audituese duhet të realizohet nga: përgjegjësi i grupit të angazhimit, përgjegjësi i sektorit, çdo funksion tjetër i njësuar me këto pozicione dhe nga Drejtuesi i Njësisë së Auditimit.

Bashkëlidhur:

1. Pasqyra nr.1: Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet për vitin 2025
2. Pasqyra nr.2: Plani strategjik I subjekteve të synuara për tu audituar për vitet 2025-2027
3. Pasqyra nr.3: Plani i angazhimeve të NjAB për vitin 2025
4. Pasqyra nr.4: Plani i nevojave për trajnim të NjAB për vitin 2025
5. Pasqyra nr.5: Planifikimi i buxhetit dhe Shpërndarja e burimeve të NjAB për vitin 2025

Përgjegjësi i Njësisë së AB

Donika Ndoj

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM BASHKIA MIRDITË

Pasqyra 1

Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet për vitin 2025

Nr	Subjekte për tu audituar	Fusha për tu audituar	VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RISKUT		
			I lartë	I mesëm	I ulët
a.	1	2	3	4	5
1	BASHKIA MIRDITË				
	Policia bashkiake	Zbatimi i ligjit "Për policinë bashkiake", VKM, rregullorja e bashkisë dhe urdhrat e Kryetarit të Bashkisë		I mesëm	
I	Drejtoria Juridike, Prokurimeve Publike dhe Protokollit	Auditim mbi zbatimin e ligjeve , akteve ligjore e nenligjore lidhur me prokurimet publike. Funksionimi i Drejtorise ne teresi		I mesëm	
I/1	Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Përshkrimit Punës dhe A.Përgjegjës	Rekrutimi i punonjesve ne zbatim të ligjit 152/2013 mbi "Statusin e Nepunesit Civil" dhe Kodi i Punës		I mesëm	
I/2	Spektori i Marrdhënieve me qytetarët eventeve dhe IT	Mënyra e trajtimit dhe adresimit të ankesave të qytetarëve		I mesëm	
I/3	Njësia për koordinimin e integritit europian dhe projekteve	Realizimi projekteve dhe fondet e BE		I mesëm	
II/1	Spektori juridik dhe prokurimeve	Auditim në fushën e prokurimeve		I mesëm	
II/2	Spektori i Arkivit dhe Protokollit	Mënyra e funksionimit, zbatimi rregullave të brendshme në bashki		I mesëm	
III	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave	Auditim në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm , funksionimi i kësaj drejtorie dhe organizimi i punës	I lartë		
III/1	Spektori i buxhetit dhe financës	Zbatimi i buxhetit sipas zërave të miratuar si dhe ndjekja në vazhdimësi e zbatimit të tij	I lartë		
III/2	Spektori i Tatim Taksave dhe nxitja e biznesit	Realizimi i të ardhurave plan fakt bazuar në aktet ligjore		I mesëm	
IV	Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit Territorit	Auditim në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve, vlerësimi i kërkesave për kryerje punimesh		I mesëm	

IV/1	Sektori i Planifikimit, Hartimit Projekteve dhe Monitorimit te Investimeve Publike	Auditim mbi mënyrën e organizimit të punës me sektorin e kontrollit të lejeve të ndërtimit dhe investimeve		I mesëm	
IV/2	Sektori i Zhvillimit te Territorit dhe Aplikimeve te Lejeve	Kontrolli i dokumentacionit qe përmban dosja e aplikimit për lejimin e kryerjes së punimeve. Ndjekja dhe monitorimi i punimeve		I mesëm	
IV/3	Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit	Auditim mbi vendimet e marra nga IVMT prishjen e objekteve pa leje zhvillimi. Auditimi për vendosjen e gjobave, bashkëpunimi me sektorin e financës		I mesëm	
V	Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore dhe Turizmit	Audimim mbi organizimin e punës në tërës sipas sektorëve		I mesëm	
V/1	Sektori i Kulturës dhe Muzeut	Realizimi i aktiviteteve dhe monitorimi i projekteve artistike e kulturore		I mesëm	
V/2	Sektori i Turizmit	Programet e zhvillimit të turizmit, promovimi i resurseve turistike		I mesëm	
VI	Agjencia e Inspektimit, Kontrollit dhe Emergjencave.	Mënyra e funksionimit të Agjencisë në tërësi dhe sipas sektorëve		I mesëm	
VI/1	Emergjenca Civile	Administimin e dosjeve që lidhen me menaxhimin e rasteve të emergjencave civile dhe delegimin e tyre Drejtoris së Përgjithshme		I mesëm	
VI/2	MZSH	Zbatimi i akteve ligjore dhe gatishmëria për SHMZSH		I mesëm	
VII	Agjencia e Bujqësisë Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve	Funksionimi i Agjencisë dhe bashkëpunimi me stukturat e tjera brenda bashkisë		I mesëm	
VII/1	Sektori i bujqësisë dhe kadastrës	Auditim mbi ndjekjen e procedurave administrative për plotësimin e dokumentacioneve të pronësisë dhe përcjelljen për regjistrim në ASHK		I mesëm	
VII/2	Inspektoriati i Mjedisit dhe Pyjeve	Plotësimi i kushteve mjedisore nga ana e subjekteve ndërtuese në objektet që ndërtohen në territorin e bashkisë		I mesëm	
VII/3	Sektori i monitorimit të rezervuarve dhe vaditjes	Auditim mbi administrimin, planifikimin dhe mirmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit		I ulët	
VII/4	Sektori i Sh. Veterinar, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	Monitorimi /hartimi i raporteve për situatën epidemiologjike të sëmundjeve infektive në kafshë sipas territorit. Kontrolle të ushtruara në mbrojtje të konsumatorit		I mesëm	
VII/5	Sektori i Monitorimit dhe Shërbimit Pyjor	Auditim mbi hartimin e politikave dhe planeve për mbrojtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin e kontrolluar të fondit pyjor dhe kullor		I mesëm	
VIII	Agjencia e Arsimit Sportit dhe Ndhmës Sociale	Mbi organizimin e punës në tëtësi dhe sipas sektorëve.		I mesëm	
VIII/1	Ndihma Ekonomike -Drejtave dhe Strehimit Social	Zbatimi i kritereve dhe akteve ligjore për përfitimin e ndihmës ekonomike		I mesëm	
VIII/2	Qendra Kulturore e Fëmijëve	Aktivitetet e zhvilluara nga QKF, zbatimi i fondit të deleguar		I mesëm	
VIII/3	Sektori i Zhvillimit të Sporteve	Organizimi i eventeve sportive, biletat, arkëtimet etj		I mesëm	
IX	NJESITË ADMINISTRATIVE	Organizimi dhe funksionimi i Njërive Administrative		I mesëm	

IX/1	Njësia Administrative Rrëshen	Adresimi dhe zgjidhja e problemeve si dhe ofrimi i shërbimeve ndaj banorëve të njësive administrative			I ulët
IX/2	Njësia Administrative Rubik	Adresimi dhe zgjidhja e problemeve si dhe ofrimi i shërbimeve ndaj banorëve të njësive administrative		I mesëm	
IX/3	Njësia Administrative Orosh	Adresimi dhe zgjidhja e problemeve si dhe ofrimi i shërbimeve ndaj banorëve të njësive administrative		I mesëm	
IX/4	Njësia Administrative Fan	Adresimi dhe zgjidhja e problemeve si dhe ofrimi i shërbimeve ndaj banorëve të njësive administrative		I mesëm	
IX/5	Njësia Administrative Kthellë	Adresimi dhe zgjidhja e problemeve si dhe ofrimi i shërbimeve ndaj banorëve të njësive administrative		I mesëm	
IX/6	Njësia Administrative Kaçinar	Adresimi dhe zgjidhja e problemeve si dhe ofrimi i shërbimeve ndaj banorëve të njësive administrative		I mesëm	
IX/7	Njësia Administrative Selitë	Adresimi dhe zgjidhja e problemeve si dhe ofrimi i shërbimeve ndaj banorëve të njësive administrative		I mesëm	
X	Agjencia Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes	Auditim mbi adminidtrimin e shërbimeve publike dhe infrastruktures rrugore si dhe në fushën e pastrimit dhe gjelberimit. Organizimi dhe funksionimi i Agjencisë në teresi		I mesëm	

P/Sektori i AB

Donika Ndoj

KRYETARI
Albert MËLYSHI



NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË BASHKINË MIRDITË

Plani strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar për vitet 2025-2027


Pasqyra 2

SUBJEKTE TË SYNUARA PËR TU AUDITUAR SIPAS VITEVE						
Nr	Viti planifikuar	Niveli i Riskut (V. planifikuar)	Viti I planif+1	Niveli i Riskut (V. planif.+1)	Viti I planif+2	Niveli i Riskut (V. planif+2)
	2025		2026		2027	
	1		2		3	
	BASHKIA MIRDITE		BASHKIA MIRDITE		BASHKIA MIRDITE	
	Policia bashkiake		Policia bashkiake		Policia bashkiake	
I	Drejtoria Juridike, Prokurimeve Publike dhe Protokollit		Drejtoria Juridike, Prokurimeve Publike dhe Protokollit	I mesëm	Drejtoria Juridike, Prokurimeve Publike dhe Protokollit	I mesëm
/1	Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Përshkrimit Punës dhe A.Përgjegjës		Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Përshkrimit Punës dhe A.Përgjegjës		Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Përshkrimit Punës dhe A.Përgjegjës	
/2	Spektori i Marrdhënive me qytetarët eventeve dhe IT		Spektori i Marrdhënive me qytetarët eventeve dhe IT		Spektori i Marrdhënive me qytetarët eventeve dhe IT	
/3	Njësia për koordinimin e integrimit europian dhe projekteve		Njësia për koordinimin e integrimit europian dhe projekteve		Njësia për koordinimin e integrimit europian dhe projekteve	
/1	Spektori juridik dhe prokurimeve		Spektori juridik dhe prokurimeve	I mesëm	Spektori juridik dhe prokurimeve	
/2	Spektori i Arkivit dhe Protokollit		Spektori i Arkivit dhe Protokollit	I mesëm	Spektori i Arkivit dhe Protokollit	I mesëm
II	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave	I lartë	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave	I mesëm	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave	
I/1	Spektori i buxhetit dhe financës		Spektori i buxhetit dhe financës	I mesëm	Spektori i buxhetit dhe financës	
I/2	Spektori i Tatim Taksave dhe nxitja e biznesit	I lartë	Spektori i Tatim Taksave dhe nxitja e biznesit		Spektori i Tatim Taksave dhe nxitja e biznesit	
V	Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit Territorit		Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit Territorit	I mesëm	Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit Territorit	I mesëm

V/1	Sektori i Planifikimit, Hartimit Projekteve dhe Monitorimit te Investimeve Publike		Sektori i Planifikimit, Hartimit Projekteve dhe Monitorimit te Investimeve Publike	I mesëm	Sektori i Planifikimit, Hartimit Projekteve dhe Monitorimit te Investimeve Publike	
V/2	Sektori i Zhvillimit te Territorit dhe Aplikimeve te Lejeve		Sektori i Zhvillimit te Territorit dhe Aplikimeve te Lejeve		Sektori i Zhvillimit te Territorit dhe Aplikimeve te Lejeve	I mesëm
V/3	Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit		Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit		Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit	
V	Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore dhe Turizmit		Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore dhe Turizmit		Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore dhe Turizmit	
/1	Sektori i Kulturës dhe Muzeut		Sektori i Kulturës dhe Muzeut		Sektori i Kulturës dhe Muzeut	
/2	Sektori i Turizmit		Sektori i Turizmit		Sektori i Turizmit	
VI	Agjencia e Inspektimit, Kontrollit dhe Emergjencave.	I mesëm	Agjencia e Inspektimit, Kontrollit dhe Emergjencave.	I mesëm	Agjencia e Inspektimit, Kontrollit dhe Emergjencave.	I mesëm
/1	Emergjenca Civile		Emergjenca Civile	I mesëm	Emergjenca Civile	
/2	MZSH		MZSH	I mesëm	MZSH	
/II	Agjencia e Bujqësisë Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve	I mesëm	Agjencia e Bujqësisë Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve	I mesëm	Agjencia e Bujqësisë Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve	I mesëm
II/1	Sektori i bujqësisë dhe kadastrës		Sektori i bujqësisë dhe kadastrës	I mesëm	Sektori i bujqësisë dhe kadastrës	
II/2	Inspektoriati i Mjedisit dhe Pyjeve		Inspektoriati i Mjedisit dhe Pyjeve		Inspektoriati i Mjedisit dhe Pyjeve	I mesëm
II/3	Sektori i monitorimit tw rezervuarve dhe vaditjes		Sektori i monitorimit tw rezervuarve dhe vaditjes	I ulët	Sektori i monitorimit tw rezervuarve dhe vaditjes	I ulët
II/4	Sektori i Sh. Veterinar, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit		Sektori i Sh. Veterinar, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit		Sektori i Sh. Veterinar, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	I mesëm
II/5	Sektori i Monitorimit dhe Shërbimit Pyjor		Sektori i Monitorimit dhe Shërbimit Pyjor	I mesëm	Sektori i Monitorimit dhe Shërbimit Pyjor	
III	Agjencia e Arsimit Sportit dhe Ndihmës Sociale	I mesëm	Agjencia e Arsimit Sportit dhe Ndihmës Sociale	I mesëm	Agjencia e Arsimit Sportit dhe Ndihmës Sociale	I mesëm
II/1	Ndihma Ekonomike -Drejtave dhe Strehimit Social		Ndihma Ekonomike -Drejtave dhe Strehimit Social	I mesëm	Ndihma Ekonomike -Drejtave dhe Strehimit Social	
II/2	Qendra Kulturore e Fëmijëve		Qendra Kulturore e Fëmijëve		Qendra Kulturore e Fëmijëve	
II/3	Sektori i Zhvillimit të Sporteve		Sektori i Zhvillimit të Sporteve		Sektori i Zhvillimit të Sporteve	I mesëm
X	NJESITË ADMINISTRATIVE		NJESITË ADMINISTRATIVE	I mesëm	NJESITË ADMINISTRATIVE	
ç/1	Njësia Administrative Rrëshen		Njësia Administrative Rrëshen		Njësia Administrative Rrëshen	I ulët
ç/2	Njësia Administrative Rubik		Njësia Administrative Rubik	I ulët	Njësia Administrative Rubik	I mesëm
ç/3	Njësia Administrative Orosh		Njësia Administrative Orosh	I mesëm	Njësia Administrative Orosh	I mesëm

X/4	Njësia Administrative Fan	I mesëm	Njësia Administrative Fan	I mesëm	Njësia Administrative Fan	
X/5	Njësia Administrative Kthellë		Njësia Administrative Kthellë		Njësia Administrative Kthellë	I mesëm
X/6	Njësia Administrative Kaçinar		Njësia Administrative Kaçinar	I mesëm	Njësia Administrative Kaçinar	
X/7	Njësia Administrative Selitë		Njësia Administrative Selitë		Njësia Administrative Selitë	I ulët
X	Agjencia Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes	I lartë	Agjencia Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes	I ulët	Agjencia Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes	
XI	UJESJELLES KANALIZIMET Sh.a.	I lartë	UJESJELLES KANALIZIMET Sh.a.		UJESJELLES KANALIZIMET Sh.a.	

P/Spektori i AB
Donika Ndoj



KRYETARI
Albert MËLYSHI



NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM BASHKIA MIRDITË


Pasqyra 3

Plani i angazhimeve të NJAB për vitin 2025

Nr	Subjekte të synuara për tu audituar	Fusha për tu audituar	Auditime Gjithsej (4.1+4.2+4.3+4.4+4.5+4.6)	Shërbimet e Sigurisë					Shërbimet e konsulentës	Grupi i Auditimit (nr.auditues)
				A. të përputhshmërisë	A. të performancës	Financiare	A.tek.Informacionit	A. të kombinuara		
a.	1	2	3	4,1	4,2	4,3	4,4	4,5	4,6	5
I	BASHKIA MIRDITE									
1	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave	Auditim në fushën e menaxhimit Financiar dhe kontrollit të brendshëm,funksionimi I kësaj drejtorie dhe organizimi I punës	1	0	0	1	0	0	0	3
1,1	Sektori i buxhetit dhe financës	Zbatimi I buxhetit sipas zërave të miratuar si dhe ndjekja në vazhdimësi e zbatimit të tij.	1	0	0	1	0	0	0	3
1,2	Sektori i Tatim Taksave dhe nxitja e biznesit	Kontroll mbi realizimin e të ardhurave të planifikuara bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi	1	1	0	0	0	0	0	3
2	Drejtoria Juridike,Prokurimeve Publike dhe Protokollit	Auditim mbi zbatimin e ligjeve , akteve ligjore e nenligjore lidhur me prokurimet publike. Funkcionimi i Drejtorise ne teresi	1	1	0	0	0	0	0	3

2,1	Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Përshkrimit Punës dhe A.Përgjegjës	Rekrutimi i punonjesve ne zbatim të ligjit 152/2013 mbi "Statusin e Nepunesit Civil" dhe Kodi i Punës	1	1	0	0	0	0	0	3
2,2	Sektori i Marrdhënieve me qytetarët eventeve dhe IT	Mënyra e trajtimit dhe adresimit të ankesave të qytetarëve	1	1	0	0	0	0	0	3
2,3	Njësia për koordinimin e integrimit european dhe projekteve	Realizimi projekteve dhe fondet e BE								
2,4	Sektori juridik dhe prokurimeve	Auditim në fushën e prokurimeve	1	1	0	0	0	0	0	3
2,5	Sektori i Arkivit dhe Protokollit	Mënyra e funksionimit, zbatimimi rregullave të brendshme në bashki	1	1	0	0	0	0	0	3
3	Policia bashkiake	Zbatimimi i ligjit "Për policinë bashkiake", VKM, rregullorja e bashkisë dhe urdhrat e Kryetarit të Bashkisë	1	1	0	0	0	0	0	3
4	Njësia Administrative Rubik	Adresimi dhe zgjidhja e problemeve si dhe ofrimi i shërbimeve ndaj banorëve të njësive administrative	1	1	0	0	0	0	0	3
5	Njësia Administrative Kaçinar	Adresimi dhe zgjidhja e problemeve si dhe ofrimi i shërbimeve ndaj banorëve të njësive administrative								
	SHUMA		5	4	0	1	0	0	0	

P/Sektori i AB
Donika Ndoj



KRYETARI
Albert MËLYSHI




NJESIA AUDITIT TE BRENDSHEM BASHKIA MIRDITE

Pasqyra 4

Planifikimi i nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2025

Nr	TEMATIKA E IDENTIFIKUAR PER TRAJNIM	Pjesmarres ne trajnim (nr.personave)	Periudha (gjate vitit)	Kohezgjatja e trajnimit (ne dite)
a	1	2	3	4
1	Harta dhe Manuali I Proceseve të Punës dhe Gjurma e Auditimit	3	Sipas planifikimit nga DH/NJ	5(dite)
3	Sistemi I kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes vendore	3	Sipas planifikimit nga DH/NJ	5(dite)
4	Trajnimi I vijueshëm profesional	3	Sipas planifikimit nga DH/NJ	5(dite)
	SHUMA			3x5=15 Dite

P/Spektori i AB
Donika Ndoj



KRYETARI
Albert MËLYSHI



NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM BASHKIA MIRDITË

Pasqyra 5

Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2025

Nr	BURIMET E PLANIFIKUARA			Nr	BUXHETI I PLANIFIKUAR	
	Shpërndarja e Burimeve Njerëzore të NJAB	Ditë për tregues	Përlllogaritja e burimeve		Treguesit e Kostos së Burimeve Njerëzore të NJAB	Plani
	1	2	3		1	2
1	Koha maksimale e vlefshme	780	52javë x 5ditë x 3 persona	1	Buxheti Gjithsej	4.814.660
2	Pushime Vjetore	60	4javë x 5 ditë x 3 persona	2	Paga dhe Sig.Shoqërore	4.694.660
3	Dite pushimi (Festa Zyrtare)	39	13 ditë x 3 persona	3	Shpenzime Udhëtimi & Dieta	75.000
4	Pushime për arsye shëndetësore	15	5 ditë x 3 persona	4	Të tjera	45.000
5	Angazhime në trajnime	15	5 ditë x 3 persona	5	Numri i Punonjësve	3
6	Angazhime në mbledhje/takime	12	4 ditë x 3 persona	6	Kosto për Person (1/3)	1.604.887
7	Rezerva të Planifikuara (të papritura)	15	5 ditë x 3 persona			
	TOTALI	624	208			

P/Spektori i AB

Donika Ndoj



KRYETARI

Albert MËLYSHI

